

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu kryesues, Rafet Haxhaj e Isa Shala - anëtarë, (më tej kolegji) në çështjen juridike të palës së mbrojtur B.B. nga Mitrovica ... e përfaqësuar nga mbrojtësi i viktimave E.P, kundër personit përgjegjës R.P. nga..., për vërtetimin e urdhrit mbrojtës, duke vendosur sipas ankesës së palës përgjegjëse, të paraqitur kundër aktvendimit plotësues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.01/2016 i datës 26.02.2016, pas mbajtjes të seancës së kolegjit, me datë 15.12.2016, jep:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të personit përgjegjës R.P. nga..., dhe **Vërtetohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.01/2016 i datës 26.02.2016, ndërsa kundër aktvendimit C.nr.01/2016 të dt. 04.02.2016, ankesa **hedhet** si e vonuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin C.nr.01/2016 i datës 26.02.2016, ka vendosur si vijon:

“Urdhri mbrojtës, i dt. 04.02.2016, plotësohet në pikën 7, ashtu që alimentacioni duhet të paguhet në xhirollogarinë bankare nr.xxx N. Bank.

Në pjesën tjetër mbetet i pa ndryshuar.”

Kundër aktvendimit plotësues ishte i lejuar ankimi në afat prej 8 ditësh.

Kundër këtij aktvendimi personi përgjegjës, R.P., me datën 03.11.2016, ka paraqitur ankesë, me të cilën ka kërkuar që aktvendimi ankimor të anulohet, dhe çështja të kthehet në rigjykim, duke pohuar se për çështjen e alimentacionit kanë vendosur dy gjykata, Gjykata Themelore në Mitrovicë, përkohësisht e vendosur në Vushtrri, dhe Gjykata Themelore në Mitrovicën e Kosovës (si gjykatë paralele) duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kompetenca: Gjykata e Apelit, ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje ankimore, duke u bazuar në dispozitat ligjore të neneve 17.1, 18.1 e 19.1 të Ligjit për Gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.79/2010)

Vlerësimi formal i ankesës: Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës si dhe ankesës konstatoi se ankesa kundër aktvendimit plotësues është brenda afatit ligjor, është e lejueshme dhe i përmban elementet e nevojshme për procedim, pra i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 19.1 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr.03/L-132 (më tej LMDHF), lidhur me nenet 178 e 181 të LPK.

Kufijtë e ekzaminimit të aktvendimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, ekzaminojë aktvendimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (me tej LPK) dhe gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë, me kërkesën e palës së mbrojtur, e pas mbajtjes së seancës gjyqësore të dt. 04.02.2016, ka dhënë urdhrin mbrojtës me të cilin ka vendosur si vijon: Vërtetohet Urdhri Emergjent i lëshuar me dt. 06.01.2016 dhe ky urdhër tani me këtë aktvendim lëshohet me këto masa:

Urdhërohet pala përgjegjëse që të përmbahet nga çfarëdo forme e shqetësimit, qoftë drejtpërdrejtë apo përmes mjeteve të komunikimit në raport me palën e mbrojtur siç parashihet me Ligjin për mbrojtje nga Dhuna në Familje, neni 2 i këtij ligji.

I ndalohet palës përgjegjëse që ti afrohet palës së mbrojtur në një perimetër prej 30 metrave në vendin ku banon në Rr....dhe në adresën e prindërve ...

Ky urdhër lëshohet për një afat 8 mujor llogaritet nga data 12.01.2016 deri me 12.09.2016.

Fëmijët e mitur: A. dhe D. i besohen në ruajtje dhe përkujdesje palës së mbrojtur si nënë.

Obligohet pala e mbrojtur që palës përgjegjëse t'ia mundëson kontaktin me fëmijë 1 herë në javë ditën e premte nga ora 09 deri në ora 13, pranimit dorëzimi i fëmijëve bëhet në Lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë.

Obligohet Qendra për punë Sociale në Mitrovicë, që të raporton në baza të rregullta mujore Gjykatën për mbarëvajtjen e këtyre kontakteve.

Obligohet pala përgjegjëse që në emër të alimentacionit për dy fëmijët e tij t'ia paguaj palës së mbrojtur shumën prej 100 euro (2 x 50 euro), ndërsa në emër të qirasë për banesë t'ia paguaj palës përgjegjëse shumën prej 100 euro, nga data 12.01.2016 deri me 12.09.2016, nga 01-05 të çdo muaji.

Shkelja e Urdhrit për mbrojtje paraqet vepër penale dhe ndiqet sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Urdhrin për mbrojtje e ekzekuton Policia e Kosovës në Mitrovicë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Pejë”.

Kundër këtij urdhri ishte lejuar ankimi në afat prej 8 ditësh, nga dita kur kopja e tij i dorëzohet palës.

Aktvendimi i dt. 04.02.2016, personit përgjegjës i është dorëzuar me dt. 29.03.2016, fakt që vërtetohet nga fletë kthesa në shkresa, ndërsa nga dt. 07.04.2016 ky aktvendim ishte i formës së prerë sepse personi përgjegjës nuk kishte paraqitur ankesë brenda afatit ligjor prej 8 ditësh të caktuar me nenin 19.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Pala e mbrojtur me parashtrësën e saj të dt. 24.02.2016, i ishte drejtuar gjykatës së shkallës së parë që pagesa e alimentacionit t'i bëhet në xhirollogarinë dhe bankën e specifikuar si në dispozitivin e aktvendimit plotësues të dt. 26.02.2016.

Kolegji, konstaton se ankesa e personit përgjegjës, e paraqitur ndaj aktvendimit plotësues të dt. 26.02.2016, ishte e pathemeltë, sepse pretendimet ankimore nuk i referohen aktvendimit plotësues, por aktvendimit të dt. 04.02.2016, i cili tani më është i formës së prerë, dhe nuk mund të shqyrtohet themelësia e tij, sepse në raport me aktvendimin e dt. 04.02.2016, kishte skaduar afati ligjor i ankesës.

Andaj, pretendimet ankimore të personit përgjegjës janë të pabazuara në ligj dhe si të tilla nuk janë me ndikim në vendimmarrje tjetër, nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë në aktvendimin plotësues, ndërsa në raport me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.01/2016 të dt. 04.02.2016, ankesa është e vonuar dhe si e tillë nuk është me ndikim, në shqyrtimin e themelësisë së këtij aktvendimi.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga nenet 196 e 209 b) të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA.nr.4437/2016 dt. 15.12.2016

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari
Gani Avdiu